



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 80-të të mbajtur më 18.01.2023 ka miratuar si në vijim.

#### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-6596/1 të datës 29.06.2022, kundër personave /// dhe /// HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, dhe lënda do t'i dërgohet për veprim kompetent Drejtorisë së të Hyrave Publike të RMV-së dhe SPB Ohër. - Ministria e Punëve të Brendshme.

Lënda me numër 12-6596/1 të datës 29.06.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Me datë 29.06.2022, nga një parashtrues i njohur është dorëzuar denoncim kundër personave /// dhe /// dhe është formuar lënda me numër 12-6596/1 e datës 29.06.2022.

Në denoncim, parashtruesi i denoncimit thekson se personat e treguar janë të përfshirë në tregti të paligjshme të marrësve /// në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj dhe se në mënyrë të kundërligjshme kanë kryer pirateri dhe vjedhje të një numri të madh të kanaleve televizive, ndërsa nuk kanë pasur kompani e regjistruar dhe nuk i ka paguar taksat shtetit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë , KSHPK-ja ka konstatuar se në denoncim, personat e denoncuar nuk janë persona zyrtarë në kuptim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit , pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, dhe lënda do të dërgohet për veprim kompetent në Drejtorin për të Hyra Publike të RMV-së dhe SPB Ohër - Ministria e Punëve të Brendshme.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Me respekt

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЕ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Нёнкрыетар  
Vladimir Georgiev

Pёrgatiti: E.N, Kёshilltar  
Miratoi: SPD, anёtar

